

PUNËSIMI DHE DINAMIKAT E TIJ GJATË VITIT TË COVID-19 (2020)

Mars, 2021



Struktura e analizës

1. Panorama përgjithshme e bizneseve dhe punësimit në 2020
2. Shpërndarja e bizneseve sipas qarqeve/rajoneve në fillim të pandemisë
3. Pesha e Tiranës dhe secilit qark/rajon për bizneset
4. Efektet e pandemisë te punësimi
5. Rajonet e vendit që kanë pakësimin më të madh, si dhe kush ka shtesat më të mëdha të punësimit
6. Si ka ndikuar pandemia te numri të vetëpunësuarve dhe atyre të punësuar?
7. Rajonet kufitare, bizneset dhe punësimi
8. Aktivitetet më të prekur nga efektet e Covid-19 dhe punësimi
9. Ecuria e punësimit në bizneset e mëdha
10. Pritshmëria e ndikimit në konsum aty ku ka ndryshim të fuqisë punëtore
11. Komente për faktet


Në tremujorin e tretë të vitit 2020, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, për popullsinë 15-64 vjeç, është 69,8 %. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2019, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është në të njëjtin nivel, ndërkohë krahasuar me tremujorin e parë 2020 ky tregues shënon një rritje prej 0.2 pikë përqindje.

Në tremujorin e tretë 2020, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 61,3 %. Gjatë këtij tremujori, në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit 2019, numri i të punësuarve gjithsej u ul me 1,2 %, ndërkohë krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2020, ky tregues u ul me 0.1 %.

Panorama përgjithshme e bizneseve dhe punësimit në 2020

Në një shikim të nivelit të punësimit në vend përpara fillimit të pandemisë më të madhe të jetuar ndonjëherë në Shqipëri, ashtu si dhe në gjithë botën bizneset janë ato që u ndikuan direkt, pavarësisht nëse janë pjesë e sektorit privat apo publik.

Struktura e bizneseve, Shkurt 2020



Nga të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat janë përpunuar dhe llogaritur për të bërë sa më të lehtë kuptimin e efekteve, shikohet se në fillim të vitit 2020 në Shqipëri operonin gjithsej 113 mijë biznese. Peshën më të madhe e mbajnë të vetëpunësuarit (bizneset me vetëm 1 punëmarrës). Këto biznese përbëjnë 57 për qind të gjithë numrit të bizneseve në vend. Por, së bashku me bizneset që kanë nga 2 deri 10 të punësuar, të cilat kuptohen si biznese të vogla ato zënë sa 93 për qind të gjithë bizneseve.

Krahas bizneseve të vogla, në fillim të vitit 2020 në treg operonin edhe biznese të mesme me një peshë sa 5 për qind e bizneseve gjithsej.

Grupi i fundit i bizneseve, të cilët janë bizneset e mëdha (VIP), si dhe ndërmarrjet e mëdha publike në energjetikë, në sektorin e hidrokarbureve, por edhe kompanitë më të mëdha private zë një peshë sa 2 për qind e bizneseve në vend.

Bizneset e vogla dhe të mesme (përfshirë edhe vetëpunësimet/mikrobizneset) përbëjnë 98.3% të të gjitha aktiviteteve/bizneseve në Dhjetor 2020, me një rritje mjaft të lehtë prej 0.1% të peshë së

tyre në raport me totalin e bizneseve. Këto kategori biznesesh dhe përbëjnë 48.7% të punësimit total të sektorit të biznesit me një rritje mjaft të lehtë prej 0.1%.


Bizneset e mëdha dhe shumë të mëdha (përfshirë institucionet publike dhe ndërmarrjet publike) përbëjnë vetëm 1.7% të numrit të bizneseve në vend, me një ulje mjaft të lehtë në raport me Shkurt 2020.

Duke pasur parasysh kontributin e tyre thelbësor në ekonomi, sigurimi i mbështetjes për sektorin privat është shumë i rëndësishëm për të zbutur rënien ekonomike dhe për të ruajtur vendet e punës. Deri më tani, ka prova empirike shumë të kufizuara në dispozicion se si kriza COVID-19 ka prekur bizneset e vogla dhe të mesme (NVM), por ende nuk ka studim analitik për to. Sidoqoftë, bazuar në të dhënat e reja dhe ekskluzive të këtij studimi, mund të gjykohet se NVM-të do të përballen me humbje të mëdha në të ardhura dhe do të kenë burime të kufizuara financiare për t'i bërë ballë një skenari krize afatgjatë.

Kërkesa e reduktuar e konsumatorëve do të çojë në probleme të qarkullimit të parasë, duke kërcënuar mbijetesën e një numri të gjerë të bizneseve. Pak më shumë se 25% e të gjitha NVM-ve operojnë në sektorin e prodhimit përfshirë edhe prodhimet bujqësore dhe detare. Pjesa më e madhe e tyre, mbi 66% janë në sektorin e shërbimeve dhe të tregtisë përfshirë edhe transportin. Ndërtimi mban një pjesë në totalin e aktiviteteve prej jo më shumë se 9%. Sidomos ata që operojnë në sektorë të orientuar drejt eksportit, të tilla si industria minerare, energjetike dhe agropërpunimi dhe turizmi janë gradualisht duke u prekur më rëndë nga ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit dhe kërkesa konsumatore e ulët. Duke pasur parasysh lidhjet e ngushta tregtare të vendit me Italinë, Greqinë dhe shtete të tjera anëtare të BE-së një nga vendet më të prekura nga COVID-19, kjo ka ndikuar veçanërisht në ndikimin edhe të diversifikimit të disa linjave prodhuese për nevoja të vogla të tregut të brendshëm.

Shpërndarja e bizneseve sipas qarqeve/rajoneve në fillim të pandemisë

Në bazë të shpërndarjes së bizneseve në vend, shihet se bizneset mikro, që përbëhen me vetëm një




të punësuar (të vetëpunësuarit) kanë një përqendrim të madh në Tiranë. Në kryeqytet operojnë 39 për qind e gjithë mikrobizneseve. Një rajon tjetër që vjen pas Tiranës është Durrësi (11 për qind), Fieri (10 për qind), Vlora dhe Elbasani (8 për qind), Shkodra (6 për qind). Rajonet me më pak mikrobiznese janë Kukësi (1 për qind) dhe Gjirokastra e Dibra (2 për qind).

Bizneset e vogla (2 deri 10 të punësuar) prezantohen me një përqendrim më të madh në rajonin e Tiranës (47 për qind)

dhe të Durrësit (12 për qind), ku të dy rajonet së bashku përmbajnë 59 për qind të gjithë bizneseve të vogla. Në rajonin e Fierit operojnë 10 për qind e bizneseve të vogla në vend, në Vlorë dhe Elbasan respektivisht 8 për qind dhe në Korçë dhe Shkodër respektivisht 6 për qind e tyre.

Përhapjen më të vogël të bizneseve të vogla e gjejmë në Kukës (1 për qind) dhe në Gjirokastrë dhe Dibër me nga 2 për qind në secilin rajon.

Ndërsa, përhapja e bizneseve të vogla është e përqendruar kryesisht në Tiranë dhe Durrës, situata



e përhapjes së bizneseve të mesme dhe të mëdha është edhe më e lartë në Tiranë, ku operojnë në fillim të vitit 2020 50 për qind e bizneseve të mesme të vendit dhe 59 për qind e bizneseve të mëdha.

Durrësi ka një përqendrim me 12 për qind të bizneseve të mesme dhe 11 për qind të bizneseve të mëdha. Rajonet e Kukësit, Dibrës dhe Gjirokastrës kanë një përqendrim të bizneseve të mesme dhe të mëdha poshtë nivelit 2 për qind

në rang vendi.

NDRYSHIMI - Numër subjektsh, Dhjetor 2020-Shkurt 2020

Nr.	Vetëpunësu	Bizneset e	Bizneset e	Bizneset e
	arit	vogla	mesme	mëdha
Tiranë	4%	8%	-8%	8%
Durrës	1%	4%	2%	17%
Elbasan	1%	0.4%	5%	-8%
Fier	2%	1%	-8%	15%
Korçë	0.3%	2%	-10%	0%
Shkodër	3%	-1%	-2%	-6%
Vlorë	10%	8%	-4%	-9%
Lezhë	3%	4%	-3%	0%
Gjirokastrë	-2%	2%	-7%	0%
Sarandë	6%	3%	0%	0%
Kukës	3%	2%	-6%	0%
Dibër	-2%	4%	0%	36%
Berat	1%	5%	10%	0%
Total	24%	39%	-30%	-28%

Burimi: MFE

Në analizën e ndikimit të bizneseve nga pandemia, në një krahasim midis numrit të bizneseve në Dhjetor 2020 me muajin Shkurt 2020, prezantohet një situatë sipas tabelës. Të dhënat e tabelës janë rezultati i krahasimit midis dy periudhave (para fillimit të pandemisë dhe mbylljes së vitit

2020). Një fakt interesant në këtë panoramë të shtimit dhe pakësimit të bizneseve sipas rajoneve dhe kategorive të bizneseve është numri i rritur i tyre në nivel kombëtar. Duke konsideruar faktet se brenda kësaj periudhe janë hapur dhe mbyllur biznese të ndryshme, si dhe duke konsideruar gjithashtu se në të dy periudhat kemi “të fotografuar” situata faktike të bizneseve, duket se rritja për gjithë vendin është me 2.3 për qind (1560 mikrobiznese, 1190 biznese të vogla, pakësuar 90 biznese të mesme dhe 10 biznese të mëdha).

Ndryshimet në rritje për bizneset me të vetëpunësuar dhe ato të vogla vijnë kryesisht për shkak të ndryshimit të ligjit për deklarimin e të ardhurave të integruara për gjithë punonjësit që kanë më shumë se një punësim. Ky ndryshim duke se ka ndikuar në rritjen e numrit të bizneseve me 1 punëmarrës. Ndërkohë, rritja vjen edhe për shkak të një regjistrimi në rutinën e tyre vjetore për të mbyllur licencat e vjetra dhe për të hapur të reja. Kjo situatë në raport me lejet provohet nga të dhënat e INSTAT, ku matjet e kryera sipas Anketës së tremujorit të tretë të Forcave të Punës, në të cilën përmendet se numri i të punësuarve gjithsej është ulur me 1,2 %, ndërkohë krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2020, ky tregues u ul me 0.1 %.

Në analizën e aktiviteteve më të prekura duket se janë bizneset e mesme, të cilat operojnë në sektorin e shërbimeve, ku veçanërisht janë shërbimet e lidhura me turizmin, si dhe aktivitetet prodhuese dhe ato që kryejnë shërbime të natyrave të ndryshme profesionale. Më pak të prekur janë tregtia e gjithë artikujve, por edhe ndërtimi.

Efektet e pandemisë të punësimit dhe tregu i punës

Në shikimin e tregut të punës mbetet ende një fakt që është analizuar pak lidhur me punonjësit e tregut informal të punës, të cilët përbëjnë jo pak. Sipas të dhënave të Bankës Botërore¹ për tregun e punës dhe problemet e tij në Ballkanin Perëndimor përmendet se bazuar në të dhënat e fundit i përkasin vitit 2018 informaliteti në gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor mbetet i lartë, si në pjesën e prodhimit të përgjithshëm, ashtu edhe në numrin e njerëzve të punësuar. Punësimi informal në vitin 2018 për Shqipërinë ishte sa 37% e tregut të punës.


Nisur nga ky fakt i prezencës së tregut informal, në tërësinë e të dhënave të INSTAT dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk përfshihen edhe punonjësit e këtij tregu shumë të madh. Kjo situatë alarmante, e cila ka ndikuar njësoj edhe për punonjësit e këtij tregu ka marrë një pjesë prej të paktën 2% të tyre, duke rezultuar në regjistrime të bizneseve të reja me të vetëpunësuar dhe biznese të vogla, sipas tabelës më lart.

Por, le të analizojmë të dhënat në dispozicion për të parë se si paraqitet tregu i punës dhe punësimet sipas të dhënave zyrtare për vitin 2020, i cili është viti i parë i pandemisë Covid-19.

Sipas të dhënave statistikore për numrin e të punësuarve në vend, në fillim të vitit 2020 tregu formal i punës (punonjësit e regjistruar në skemën e sigurimeve) regjistron një numër total prej


¹ <https://www.wb6cif.eu/wp-content/uploads/2020/05/Strategic-Response-to-Covid-19-in-SEE.pdf>

688 mijë punonjësish. Në fundin e vitit 2020 ky numër ka arritur në 692 mijë e tetëqind punonjësish.



Duket se në fund të vitit 2020 ka një rritje prej 0.7% të numrit të të punësuarave, ku pjesa më e madhe sipas analizës që vjen më poshtë i takon pjesës së tregut të të vetëpunësuarve dhe bizneseve të vogla me një rritje prej 2.4 për qind. Numri i punonjësve për bizneset e mesme dhe të mëdha ka një pakësim prej 1.7 për qind, i cili vjen kryesisht nga ndikimi i pakësimeve të bizneseve të mesme.

Në një krahasim për secilën kategori të segmentimit të punonjësve, sipas kategorive të biznesit në të cilat janë punësuar shikohet rritje me 0.1% të të vetëpunësuarve, rritje me 0.4% të bizneseve të vogla me 2-10 punonjës. Pakësimet fillojnë në kategorinë e bizneseve të mesme me 11-50 punonjës me 0.4% më pak punonjës, si dhe për kategorinë e bizneseve të mëdha me 51-500 punonjës me 0.6 punonjës më pak, si dhe për kategorinë e bizneseve më të mëdha, ndërmarrjeve publike dhe institucioneve qendrore në vend me mbi 500 punonjës me rritje 0.5%.



Në analizën e peshës që mbajnë punonjësit sipas rajoneve, në fillimin e situatës së bllokimit të tyre për shkak të pandemisë prej Covid-19 dhe të krahasuar me fundin e vitit 2020, ashtu si shikohet nga grafiku, kryeqyteti i vendit, Tirana mban një peshë gjithsej të numrit të punësuarve të siguruar me 36.7% të gjithë të të punësuarve në vend në fund viti, me një shtim prej 0.3% krahasuar me Shkurtin 2020. Durrësi është rajoni i dytë me numrin më të

madh të të punësuarve duke mbajtur një peshë prej 10.2% në nivel vendi, por me një pakësim prej 0.1% të numrit të të punësuarve. Ndërkohë, për rëndësinë e peshës dhe dimensioneve të biznesit, tatimpaguesit më të mëdhenj në vend që janë të përhapur kryesisht në Tiranë, por edhe në rajonet kryesore të vendit mbajnë një peshë në numrin e të punësuarve në fund të Dhjetorit 2020 me 18.2%

ndaj gjithë totalit të të punësuarve në vend, me një pakësim prej 0.2 për qind në krahasim me Shkurtin 2020.

Rajonet që në fund viti 2020 kanë pakësim të numrit gjithsej të punonjësve krahasuar me fillimin e pandemisë (Shkurt 2020) janë Shkodra (0.2 për qind më pak), Gjirokastra (0.1 për qind më pak). Pakësimi i numrit të punonjësve duket se është ndikuar nga largimet e punonjësve të biznesit të mesëm dhe të madh.

Rajonet që nuk kanë ndryshim të numrit gjithsej të punonjësve janë Korça, Vlora, Lezha, Kukësi, Dibra dhe Berati.

Rajoni që ka rritje të numrit gjithsej të punonjësve (përveç Tiranës) është Elbasani (0.1 për qind më shumë). Rritja e numrit të punonjësve është ndikuar nga institucionet publike.

Peshën më të madhe në numrin e të punësuarve e ka biznesi i mesëm me numër të punësuarish nga 51 deri 500 punonjës në krahasim me të gjitha kategoritë e bizneseve, për arsye të numrit më të lartë të bizneseve që operojnë.


Por, peshën kryesore e mban për numrin e të punësuarve në kategorinë e bizneseve të vogla që operojnë me 2-10 punonjës (49% të peshës gjithsej), si dhe kategorinë e bizneseve të mesme që operojnë me 11-50 punonjës. Ndërkohë, bizneset më të mëdha në vend me mbi 500 punonjës janë kategoria që kryesisht i përkasin Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Vlorës, Shkodrës dhe Fierit.

Ashtu si duket edhe në grafik, shpërndarja e të punësuarve në rajonet e tjera të vendit është dukshëm me mbi 3 herë më pak. Rajoni i Durrësit mban peshën e të punësuarve në vend, pas Tiranës me 12 për qind, ku segmentet e bizneseve të vogla që operojnë me 2-10 punonjës mbajnë një peshë sa 12% të peshës gjithsej të të punësuarve në vend, si dhe kategorinë e bizneseve të mesme që operojnë me 11-50 punonjës, ku janë punësuar një numër të punësuarish sa 12 për qind e të punësuarve për këtë kategori biznesesh në vend.

Nëse shikojmë për secilin rajon të vendit peshën e të punësuarve sipas kategorive të biznesit, shikohet se të gjitha ato e kanë kategorinë e biznesit të vogël dhe të mesëm (përjashtuar Tiranën që peshën më të madhe e ka biznesi i mesëm), që punësojnë numrin më të madh të punonjësve, duke zënë një hapësirë punësimi në numrin e përgjithshëm të secilit rajon nga 49 për qind në Fier deri në 63 për qind në Gjirokastrë.


Në këtë këndvështrim, bie në sy se në rajonet me peshë të ulët punësimi në nivel kombëtar mbahet një peshë më e madhe nga kategoritë e bizneseve të mesme në raport me ato të vogla dhe të vetëpunësuarit.

Pesha e punonjësve sipas kategorive të bizneseve, Shkurt 2020



Nëse të njëjtën analizë e zhvendosim për të parë efektet në muajin Dhjetor 2020, shikohet se pakësimet e punonjësve për të vetëpunësuarit kanë ndodhur në Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Gjirokastrë, Dibër dhe Berat.

Pesha e punonjësve sipas kategorive të bizneseve, Dhjetor 2020



Të punësuarit në bizneset e vogla janë pakësuar në Elbasan, Shkodër dhe Korçë. Pakësimet më të shumta kanë ndodhur në bizneset e mesme, në Fier, Korçë, Lezhë. Ndërsa në bizneset e mëdha ka pasur rënie të numrit të punonjësve në secilin nga rajonet shqiptare.

Si ka ndikuar pandemia te numri të vetëpunësuarve dhe atyre të punësuar?

Në analizën e të vetëpunësuarve shikohet tendenca më e madhe e rritjes në vitin 2020.

Kjo kategori e aktiviteteve është një tregues, se përtej faktit që pandemia ka ndikuar në bizneset e mesme dhe të mëdha, duket se të vetëpunësuarit janë pjesa reaguese ndaj krizës së shkaktuar për të qenë edhe një pjesë që vjen nga reagimi i masave të ndryshme në funksion të ngushtimit të hapësirave për evazion, megjithëse rritja e aktiviteteve që përdorin teknologjinë është ende nën një monitorim të pakët nga administrata fiskale.

Ndërkohë, rritja e numrit të punësuarve në fund viti 2020 në krahasim me fillimin e pandemisë, në rastin e Fierit (1300 punonjës më shumë) është tregues i efektit direkt nga investitori i vetëm i madh që ka hyrë në qytetin e Fierit në sektorin e prodhimit të pjesëve për automjete. Shtimet e punonjësve në mbarë vendin (3300 punonjës më shumë) janë treguesi i shtimit të bizneseve të shërbimeve të transportit, online, si dhe të tregtisë në biznesin e vogël, kryesisht në zonën e Tiranës dhe Durrësit. E njëjta situatë, por me përmasa më të vogla është edhe për të vetëpunësuarit, të cilët janë të përhapur masivisht në sektorin e shërbimeve profesionale.

Rajonet kufitare, bizneset dhe punësimi

Në analizën e rajoneve që janë kufitare me njeri-tjetrin ka një tendencë të bizneseve dhe punësimit për të njëjtat kategori në Tiranë dhe Durrës.

Ndërsa, Gjirokastra me Sarandën duket se nuk kanë të njëjtën strukturë të aktiviteteve dhe të punësimit dhe shikohet se Gjirokastra ka pakësim të bizneseve dhe numrit të të vetëpunësuarve, ndërsa Saranda ka të kundërtën. Për kategoritë e tjera të bizneseve të vogla, të mesme dhe të mëdha ato kanë të njëjtat tendenca pakësimi të bizneseve dhe të punësuarve, që janë të varura nga pakësimi i aktiviteteve të shërbimit turistik (Saranda) dhe të shërbimeve kulturore dhe sociale (Gjirokastra).

Në ngjashmëri nga prekja nga efektet e Covid-19 për zonat kufitare në rajonet më lart duket se ka të njëjtat ndikime edhe kur analizojmë Fierin dhe Vlorën. Edhe pse kanë struktura biznesi që varen nga ecuria e sektorëve të ndryshëm, ato kanë një rritje të të vetëpunësuarve të sektorit të shërbimeve dhe tregtisë, si dhe pakësim të të punësuarve për bizneset e mesme që ushtrojnë aktivitete në fushën e tregtisë dhe shërbimeve sociale dhe ushqimore.

Aktivitetet më të prekur nga efektet e Covid-19 dhe punësimi


Nga krahasimi midis periudhës para pandemisë me periudhën e fundvitit duket se disa nga aktivitetet që kanë një prekje më të madhe janë shërbimet e lidhura me udhëtimet, transportin dhe tregtia me shumicë e mallrave industriale joushqimore.

Më e dukshme është në rajonet e veriut të Shqipërisë, por edhe ato të jugut, pavarësisht se ka një diversifikim ende të pastabilizuar drejt aktiviteteve që janë të lidhura me shërbimet online, edhe pse në një masë mjaft të vogël në raport me aktivitetet tradicionale tregtare. Një qasje e aktiviteteve që është ndikuar për mirë është sektori i shërbimeve dhe tregtisë farmaceutike dhe mjekësore të të gjitha kategorive të bizneseve, sektori i ndërtimeve dhe ai prodhimit të materialeve për ndërtim, të cilët kanë një rritje poshtë nivelit të fillimit të pandemisë, por që duhet mbajtur në konsideratë edhe periudha sezonale e aktiviteteve.

Ecuria e punësimit në bizneset e mëdha

Bizneset e mëdha janë hambari i të punësuarve në vend, ku përfshihet me një peshë prej jo më pak se 16% edhe punonjësit e sektorit publik që i përkasin institucioneve dhe ndërmarrjeve publike me mbi 500 punonjës. Në total numri i punonjësve të sektorit publik është sa 19% të të punësuarve në nivel vendi.

Në analizën e tendencës së punësimeve në bizneset e mëdha dhe shumë të mëdha për periudhën që analizojmë shikohet se pandemia ka një ndikim në numrin e të punësuarve të këtyre bizneseve me 0.1 për qind më pak. Ndikimin kryesor e kanë kompanitë e shërbimeve dhe eksportuesit



(prodhuesit), por që ka një ndikim pozitiv nga ndërtimi me fonde publike dhe private, si dhe tregtia e produkteve dhe pajisjeve mjekësore dhe farmaceutike, si dhe shërbimet mjekësore, duke e paraqitur në totalin e analizës pakësimin e punonjësve më të vogël nga sa është në realitet.

Në krahasimin e tendencës së punësimeve midis rajoneve, pakësimet më të mëdha kanë ndodhur në bizneset e mëdha të Shkodrës, Gjirokastrës, Vlorës, Dibrës, Lezhës, Durrësit dhe

Beratit.

Tirana dhe Elbasani kanë një rritje mjaft të lehtë të numrit të të punësuarve në bizneset e mëdha. Fieri për arsye të një investimi të ndodhur në vitin 2020 ka rritjen më të madhe të punësimit në fund viti 2020 krahasuar me periudhën para fillimit të pandemisë.

Masat COVID-19 për të zbutur rreziqet e papunësisë kanë qenë reagimi parësor ndaj krizës COVID-19 që kanë synuar të mbrojnë punonjësit dhe të parandalojnë humbjen e vendit të punës duke u fokusuar rreth elementëve, të tillë si:

- Reduktimi i ekspozimit të punëtorëve ndaj virusit COVID-19 në vendin e punës: Të gjitha bizneset kanë detyrimin ligjor që të zbatojnë masat për të kufizuar ndërveprimin fizik në vendin e punës.
- Mbështetja modeste financiare për pagat e punonjësve për të kompensuar humbjen e të ardhurave të tyre të shkaktuara nga ndalja e aktivitetit ekonomik dhe për t'u ardhur në ndihmë në të njëjtën kohë pronarëve të bizneseve që të ndajnë kostot, me aq sa është mundësia e paktë e buxhetit të shtetit.

Pritshmëria e ndikimit në konsum, aty ku ka ndryshim të fuqisë punëtore

Nga të dhënat për konsumin familjar të publikuar nga INSTAT, si dhe analiza dhe studime të pjesshme lidhur me përdorimin e fondeve në kohën e bllokimit prej pandemisë në vitin 2020 duket se është mbajtur një vijë konsumi me pak luhatje nga periudha përpara pandemisë. Nisur nga fakti i ndryshimeve në migrimin e fuqisë punëtore vit pas viti e deri në vitin 2020, që konsiderohet si vit shembull, për të parë ndër të tjera edhe konsolidimin e fuqisë punëtore shikohet edhe konsumi që shoqëron zhvendosjet e fuqisë punëtore.

Ndërsa shihet se fuqi punëtore tashmë ndodhet në zonën qendrore dhe kryesisht në Tiranë dhe përreth saj, atëherë pritshmëria e rritjes së konsumit dhe gjenerimit të sa më shumë të ardhurave fiskale edhe për buxhetin është një nga mënyrat se ku duhen alokuar edhe burimet për të luftuar tregun informal të punës dhe minimizimin e tij. Ndërsa, pjesa më e madhe e konsumit ndodhet në zonën përreth kryeqytetit do të nevojitet që bizneset të planifikojnë se si të përdorin sa më mirë burimet në dispozicion për të shfrytëzuar në mënyrë më optimale mundësitë që ofrohen nga zonat me pak fuqi punëtore, me qëllim diversifikimin e portofoleve të investimeve të teknologjisë, të cilat nuk kërkojnë domosdoshmërinë e prezencës masive të fuqisë punëtore fizikisht në vendin e biznesit.

Komente për faktet

Një rikuperim i qëndrueshëm ekonomik nga kriza kërkon rritje të produktivitetit të sektorit privat përmes adoptimit të produkteve dhe proceseve të reja të përshtatura me realitetet e reja ekonomike.

Të ardhurat më të ulëta dhe shpenzimet më të larta për të zbutur ndikimin e menjëhershëm të COVID-19 kanë zvogëluar hapësirën për investime publike ose konsum për të mbështetur rimëkëmbjen pasuese të ekonomisë. Për më tepër, kriza COVID-19 padyshim do të çojë në ndryshime të përhershme në sjelljen dhe preferencat e konsumit, gjë që kërkon që sektori privat të rregullohet. Kjo përfshin një përshtetje të disa tendencave të fundit globale, të tilla si: tregtia elektronike, puna në shtëpi, mënyrat elektronike të komunikimit, etj.

Por gjithashtu, përfshin rregullimin e produkteve dhe shërbimeve në sektorë që janë prekur më fort nga kriza siç është turizmi, transporti, tregtia me pakicë, restorantet, shërbimet kulturore dhe sociale, etj.

Një rimëkëmbje e fortë dhe e qëndrueshme ekonomike kërkon që bizneset e mëdha, që janë të përgatitura dhe kanë një konsolidim financiar të miratojnë për aplikim teknologjinë e re të informacionit dhe komunikimit (TIK), si dhe shërbime dhe procese për të rritur produktivitetin e tyre. Pasi kjo i ndihmon ata të përshtaten me ndryshimet e kërkesës konsumatore të diktuar më forcë nga pandemia.